

Nr. 1468 ProtDurrës, më: 14.07.2025

## V E N D I M

Nr. 63, datë 14/07/2025**"PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË STUDIMIT PËR STUDENTËT E HUAJ NË  
UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS, PËR VITIN AKADEMIK  
2025-2026"**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; në VKM Nr. 279, datë 21.05.2025 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në republikën e shqipërisë", të ndryshuar; në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; në Urdhërin e Rektorit Nr. 291, datë 30.06.2025 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë Afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", si dhe në shkresën me Nr. 1604/1 prot., datë 07.07.2025 të Zv. Rektor për çështjet mësimore, vendim Senati Akademik nr.79, datë 08.07.2025, Bordi i Administrimit

## V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifës së studimit për studentët e huaj në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës për vitin akademik 2025-2026, bazuar në strategjinë afatshkurtër për procedurën e rekrutimit të studentëve të huaj miratuar me vendim Senati Akademik nr.79, datë 08.07.2025.
2. Tarifa e studimit do të jetë e njëjtë për studentët e huaj si për shtetasit shqiptar, sipas vendimeve respektive të Bordit të Administrimit për miratimin e tarifave të shkollimit për vitin akademik përkatës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
  - Administratori ✓
  - Drejtoria e Administrimit Financiar
  - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALLI

